



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 110 dt. 11.11.2014

Në mbështetje të nenit 17, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 11.11.2014, pasi shqyrtoi më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, kërkesën e bërë për disa punime shtesë në Urën e Velabishtit,

VENDOSI:

1. Miratimin e punimeve shtesë gjatë zbatimit të projektit të restaurimit në urën e Velabishtit, Berat.

*Të çlirohet monumenti nga mbetjet inerte dhe dherat.*

*Të hiqet tubacioni i vjetër i ujësjellësit në trupin e urës.*

*Të evidentohet gjurma e kalldrëmit të vjetër të monumentit.*

*Para vendosjes së tubacioneve të reja, të bëhet sondazh nga firma për gjetjen e kalldrëmit ekzistues të urës.*

*Në rast të evidentimit të këtyre gjurmëve, tubacioni i ri duhet të vendoset jashtë gjurmëve të kalldrëmit.*

*Propozimi për shkallët ose rampat për lidhjen e monumentit me rrugët ekzistuese të shqyrtohet në KSH dhe KKR në një fazë të mëvonshme.*

2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI